

FORMULARI VETËDEKLARIMIT TË REZIDENCËS TATIMORE

- INDIVIDË -

Rregulloret tatimore i kërkojnë Bankës Amerikane të Investimeve Sha. të mbledhë dhe të raportojë informacion të caktuar për **individin** e lidhur me një llogari financiare në lidhje me rezidencën e tij tatimore. Termi “Rregullore tatimore” i referohet rregullave të krijuara për të mundësuar shkëmbimin automatik të informacionit dhe përfshin Standardin e Përbashkët të Raportimit, të OECD-së, për shkëmbimin automatik të informacionit financiar të llogarisë (“**CRS**”), që zbatohet në juridiksionet përkatëse.

Për t’i mundësuar Bankës Amerikane të Investimeve Sha. të përmbushë detyrimet e raportimit, duhet të deklaroni rezidencën/at tatimore të personit/ave mbajtës të llogarive bankare të identifikuar, së bashku me numrin/at identifikues tatimor/ë.

Nëse ju nuk jeni llogari mbajtësi i llogarisë bankare pranë Bankës Amerikane të Investimeve Sha., por jeni duke plotësuar formularin në emër të tij (*pra në emër të një individi tjetër*), ju duhet të plotësoni **Pjesën e Parë** me të dhënat e personit i cilit është llogari mbajtës dhe të plotësoni gjithashtu lidhjen Tuaj me të në **Pjesën e Dytë**.

Ju lutem, mbani parasysh sa më poshtë:

- **Mos plotësoni këtë formular nëse nuk jeni individ.** Në vend të tij, ju lutem, plotësoni “[FORMULARI I VETËDEKLARIMIT TË REZIDENCËS TATIMORE - ENTITETE -](#)”.
- **Ju duhet të plotësoni të gjitha seksionet** në lidhje me të gjithë llogaritë e mbajtura pranë Bankës Amerikane të Investimeve Sha. dhe të jepni informacion shtesë sipas kërkesës për të evidentuar deklaratën e bërë.
- **Nëse informacioni i dhënë më poshtë në lidhje me rezidencën tatimore ndryshon**, ju duhet të dorëzoni pranë Bankës një deklaratë të re të përditësuar brenda 90 ditëve që nga ndryshimi i rrethanave.
- **Për llogaritë bashkë emërore**, secili llogari mbajtës duhet të plotësojë një formular të veçantë.
- **Banka Amerikane e Investimeve Sha. nuk lejohet të plotësojë këtë formular në emrin Tuaj.** Nëse keni pyetje për mënyrën e plotësimit të këtij formulari, përcaktimit të rezidencës Tuaj tatimore, duhet të konsultoheni me këshilltarin Tuaj për taksat ose me këshilltarin Tuaj ligjor.

PJESA E PARË

1. Identifikimi i llogari mbajtësit / personit fizik

Emri(at), Mbiemri(at):		
Data e lindjes:	Qyteti i lindjes:	Shteti i lindjes:
Adresa e rezidencës. (Ju lutemi përfshini të gjitha detajet në lidhje me adresën.)		

Jeni shtetas amerikan apo rezident në SHBA?

- PO, TIN¹-i im në SHBA është: _____. Ju lutem plotësoni gjithashtu format W9 dhe Deklaratën e Pëlqimit FATCA.
- JO
- Deklaroj se nuk kam as vendbanim të përhershëm dhe as vendbanim të zakonshëm në Shqipëri sipas interpretimit të Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë, neni 12
- Deklaroj se kam një vendbanim sekondar në Shqipëri sipas interpretimit të Ligjit nr 108/2013 për të Huajt. Ju lutemi paraqisni edhe kopjen e lejes së qëndrimit në Shqipëri në rast se nuk jeni rezident.

2. Përcaktimi rezidencës/ rezidencave për qëllime tatimore të llogari mbajtësit²:

Shteti:	Numri i Identifikimit Tatimor (TIN):	Nëse TIN nuk mund te sigurohet ju lutemi paraqisni një arsyetim të vlefshëm:
Shteti:	Numri i Identifikimit Tatimor (TIN):	Nëse TIN nuk mund te sigurohet ju lutemi paraqisni një arsyetim të vlefshëm:
Shteti:	Numri i Identifikimit Tatimor (TIN):	Nëse TIN nuk mund te sigurohet ju lutemi paraqisni një arsyetim të vlefshëm:
Shteti:	Numri i Identifikimit Tatimor (TIN):	Nëse TIN nuk mund te sigurohet ju lutemi paraqisni një arsyetim të vlefshëm:
Shteti:	Numri i Identifikimit Tatimor (TIN):	Nëse TIN nuk mund te sigurohet ju lutemi paraqisni një arsyetim të vlefshëm:

Ju lutemi, në rast se rezidenca(t) juaj tatimore është/janë të ndryshme nga shteti apo vendbanimi juaj aktual, jepni shpjegimin e arsyeshëm të bazuar në dokumentacionin përkatës.

¹ TIN është numri identifikimit personal për qëllime tatimore. Personat që kanë rezidencë tatimore në Republikën e Shqipërisë do të paraqesin numrin e tyre personal. Për më shume informacion ju ftojmë të vizitoni faqen në lidhjen vijuese: <http://www.oecd.org/tax/automatic-exchange/crs-implementation-and-assistance/tax-residency/>

² Ligjet e brendshme të juridiksioneve të ndryshme përcaktojnë kushtet në të cilat një individ duhet të trajtohet si "rezident" tatimor. Në përgjithësi, një individ do të jetë rezident për qëllime tatimore në një juridiksion nëse, sipas ligjeve të këtij juridiksioni (përfshirë konventat tatimore), ai paguan ose duhet të paguajë tatimin në të për shkak të banesës, vendbanimit ose ndonjë kriteri tjetër të një natyre të ngjashme, dhe jo vetëm nga burimet në atë juridiksion. Për informacione të mëtejshme, ju lutem klikoni në faqen e mëposhtme : <https://www.oecd.org/tax/automatic-exchange/crs-implementation-and-assistance/tax-residency/>

PJESA E DYTË

Deklarata dhe Nënshkrimi

Unë autorizoj Bankën Amerikane të Investimeve Sha. të ofrojë kopje të këtij vetë deklarami, çdo formë të IRS-se (Internal Revenue Service US) të plotësuar dhe dhënë nga unë, ose çdo lloj informacioni tjetër të nevojshëm për identifikimin e statusit të rezidencës tatimore drejt çdo autoriteti tatimor përgjegjës, çdo autoriteti të autorizuar për auditim dhe kontroll ndaj Bankës Amerikane të Investimeve Sha. për qëllime tatimore.

Unë bie dakord se sipas dispozitave të Ligjit Nr. 4/2020 "Për shkëmbimin automatik të informacionit" dhe Ligjit Nr. 9887 "Për mbrojtjen e të dhënave personale", çdo informacion i përmbajtur në këtë deklaratë dhe çdo informacion në lidhje me gjendjen e tanishme dhe të ardhshme të llogarisë(ve) bankare, përfshirë balancën(at) dhe të ardhurat nga transaksionet hyrëse, mund të raportohen drejtë, (i) çdo autoriteti përkundrejt të cilit Bankës Amerikane e Investimeve Sha. i kërkohet të raportojë informacion në lidhje me taksat, (ii) çdo pale të tretë që Banka Amerikane e Investimeve Sha. konsideron si të përshtatshme për të përmbushur kërkesat e rregulloreve FATCA dhe CRS dhe për të parandaluar shkelje të mundshme të këtyre rregulloreve (iii) një entiteti të cilin Banka Amerikane e Investimeve Sha. e përzgjedh për të përmbushur një pjesë ose të gjithë detyrimet e raportimeve FATCA dhe CRS.

Deklaroj me përgjegjësi të plotë se i gjithë informacioni i dhënë në këtë formular, në dijeninë time, është i sakte dhe i plotë. Gjithashtu, jam dakord se do të dorëzoj pranë Bankës një deklaratë të re brenda 90 ditëve nga data e ndryshimit të rrethanave nëse çfarëdo informacioni i dhënë në këtë deklaratë ndryshon.

(emër/ mbiemër me shkronja të mëdha)

(nënshkrimi) dhe Data (dd/mm/vvvv)

Shënim: Nëse nuk jeni mbajtës i llogarisë, ju lutemi tregoni statusin ligjor me të cilën po firmosni formularin. Nëse nënshkruani si "person i autorizuar me prokurë", ju lutemi bashkëngjitni edhe një kopje të prokurës apo dokumentit ligjor të përfaqësimit:

Në cilësinë e :

(emër/ mbiemër me shkronja të mëdha)

(nënshkrimi) dhe Data (dd/mm/vvvv)

SHPJEGIM I SHKURTIMEVE DHE TERMINOLOGJISE TË KËTIJ FORMULARI

Nëse keni ndonjë pyetje në lidhje me këto përkufizime ose kërkoni detaje të mëtejshme se si ta plotësoni këtë formë, ju lutemi kontaktoni këshilltarin tuaj tatimor ose autoritetin e taksave lokale. Për informacion shtesë në lidhje me Shkëmbimin automatik të informacionit, ju lutemi referojuni faqes sonë të internetit.

CRS është një shkurtim për Standardin e Përbashkët të Raportimit; CRS është standardi i përbashkët global i OECD për shkëmbimin automatik të informacionit për llogaritë financiare midis vendeve që kanë lidhur Marrëveshjen Shumëpalëshe midis Autoriteteve Kompetente. CRS zbatohet në Shqipëri me Ligjin Shqiptar 4/2020 .

FATCA është një shkurtim për Aktin e Pajtueshmërisë së Taksave në Llogaritë e Huaja. Ky legjislacion tatimor i Shteteve të Bashkuara ka për qëllim identifikimin e Personave nga ShBA që mbajnë llogari ose pasuri financiare jashtë Shteteve të Bashkuara.

Rezidenca tatimore Sipas ligjit shqiptar nr 9920 datë 19.05.2008, neni 8 "Për procedurat tatimore" Ju jeni rezident tatimor në Shqipëri nëse vendbanimi juaj i përhershëm ose i zakonshëm është në Shqipëri. Në përgjithësi, rezidenca juaj tatimore është e njëjtë me vendbanimin tuaj të përhershëm ose të zakonshëm. Sidoqoftë, secili vend ka rregullat e veta për përcaktimin e rezidencës tatimore. Ju mund ta kontrolloni këtë me legjislacionin lokal ose duke vizituar faqen <http://www.oecd.org/tax/automatic-exchange/crs-implementation-and-assistance/tax-residency/>. Ju lutemi këshillohuni me një këshilltar tatimor nëse nuk jeni të sigurtë në përcaktimin e rezidencës Tuaj tatimore.

Përkufizimi i banesës Një person ka një vendbanim sipas nenit 12 të Kodit Civil, aty ku ai / ajo ka një rezidencë që e zotëron dhe do ta përdorë vazhdimisht dhe jo përkohësisht. "Vendbanim" do të thotë dhoma të mobiluara që mund të përdoren në çdo kohë për nevoja personale pa modifikime të rëndësishme, p.sh. banesa me qira, shtëpi pushimi, dhoma me qira, dhoma hotelesh të marra me qira në mënyrë të përhershme, dhoma në banesën e prindërve të personit, etj. Një person mund të ketë disa vendbanime. SHËNIM: Banesat që janë të pabanuara ose të pa mobiluara ose janë lënë në përdorim në mënyrë të përhershme tek të tjerë nuk përbëjnë një vendbanim në Shqipëri.

Përkufizimi i vendbanimit të zakonshëm Një person ka një vendbanim të zakonshëm në kuptim të Ligjit nr 108/2013 për të Huajt dhe Ligjit 9920 datë 19.05.2008 "Për procedurat tatimore", ku ai / ajo është fizikisht i pranishëm në atë mënyrë që tregon se prania e tij / saj në atë vend ose vendi nuk është thjesht i përkohshëm. Një person konsiderohet se ka vendbanimin e tij / saj të zakonshëm në Shqipëri nëse ai / ajo qëndron në Shqipëri për një periudhë më të gjatë se 183 ditë nga 365 ditë (kjo periudhë kohore pezullohet nga qëndrimet e përkohshme jashtë Shqipërisë

Përkufizimi i vendbanimit dytësor në Shqipëri Një person ka një vendbanim dytësor në Shqipëri, në zbatim të ligjit nr 108/2013 për të Huajt, nëse shumica e veprimtarive dhe qendra e interesit të këtij personi ndiqen jashtë Shqipërisë për më shumë se pesë vjet kalendarik, dhe apartamenti shqiptar, qoftë vetëm ose së bashku me apartamente të tjera në Shqipëri, nuk përdoret më shumë se 70 ditë në një vit kalendarik. Personi duhet të ketë të regjistruar numrin e ditëve kur një apartament i tillë përdoret në Shqipëri. Mbi dhe përtej kësaj, nuk ka vendbanim në Shqipëri të asnjë bashkëshorti ose partneri, i cili i nënshtrohet një detyrimi tatimor të pakufizuar nga i cili personi është ndarë përgjithmonë.